




KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY
BIFURKACIONI SH.A
Ferizaj



Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel. & Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com

Data: 14.03.2020
Për: Punëtorët e KRU Bifurkacioni Sha Ferizaj
Cc: Menaxherët e departamenteve dhe përgjegjësit e NjO-Kaçanik dhe ZSH-Hani i Elezit
Nga: **Xhabir Morina, Kryeshef Ekzekutiv**
Lënda: **Vendim**

Duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/09, Pika 9, të datës 13.03.2020, për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU Bifurkacioni ShA, në mbledhjen e jashtëzakonshme me stafin menaxhues të kompanisë, të mbajtur më 14.03.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Reduktohet stafi dhe veprimet esenciale në të gjitha departamentet e kompanisë, në Fabrikën e Prodhimit dhe Përpunimit të Ujit në Pleshinë, në Njësinë Operative në Kaçanik dhe në Zyrën e Shërbimeve në Hanin e Elezit, por duke mos rrezikuar për asnjë moment kryerjen e funksioneve themelore të kompanisë, në shërbim të konsumatorëve-qtetarëve.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh situatën e krijuar lidhur me përhapjen e Corona Virus COVID-19 dhe Vendimin e lartpërmendur të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive të këtij virusi, Kryeshefi Ekzekutiv thirri një mbledhje të jashtëzakonshme me stafin menaxhues të kompanisë, më 14.03.2020 në ora 15.00.

Në mbledhje u shqyrtua situata e krijuar, konform vendimit të qeverisë dhe në fund u mor vendim për masat përkatëse brenda kompanisë, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi është në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të punëtorëve të KRU-Bifurkacioni.

Kryeshefi Ekzekutiv

Xhabir Morina
FERIZAJ